



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike
Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost / Kosovo Academy for Public Safety

KËSHILLI I ETIKËS

RAPORT I AKTIVITETIT TË KËSHILLIT TË ETIKËS

I. TË DHËNAT BAZË

Titulli i aktivitetit:	Takimi konstituiv i Këshillit të Etikës
Data:	30.09.2025
Vendi:	Salla e takimeve, nr. 24 Objekti Drejtorisë Përgjithshme AKSP
Lloji i aktivitetit	<i>Takim</i>

II. PJEËMARRËSIT

1. z. Florentina Shala – Braha- Kryesuese
2. z. Fitim Osmani – anëtar dhe
3. z. Faton Sahiti - anëtar

Të ftuar tjerë:

- z. Shpend Shabani, U.d Drejtor i Përgjithshëm i AKSP-së
- z. Ferid Azemi, Dekan i FSP-së
- z. Emin Uka, Udhëheqës i Divizionit për Sigurimin e Cilësisë

III. PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

Më 30.09.2025 në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike u mbajt mbledhja e parë e Këshillit të Etikës, i cili ka mandatë promovimin e integritetit akademik, respektimin e normave etike dhe adresimin e çështjeve që lidhen me etikën profesionale dhe akademike.

Mbledhjen e hapi u.d. Drejtori i përgjithshëm i AKSP-së z. Shpend Shabani i cili theksoni rëndësinë e funksionimit të këtij organi për forcimin e kulturës akademike dhe përmbushjen e standardeve të akreditimit, shtoi se me themelimin e këtij Këshilli po ju shtohet edhe një vlerë institucionit tonë duke u

bazuar në rolin dhe rendësin e tij. Ne si institucion synojmë jetësimin e vlerave etike dhe të integritetit. Po ashtu u zotua se do të ofroj mbështetje për çdo iniciativë dhe aktivitet të këtij Këshilli i cili është edhe një nga indikatorët për plotësimin e standardeve të akreditimit.

Për rendësin e funksionit dhe rolin e Këshillit të Etikës foli edhe Dekani i Fakultetit të Sigurisë Publike z. Ferid Azemi, i cili falënderoi të pranishmit dhe uroj punë të mbarë anëtarëve të Këshillit duke shtuar se funksionimi i këtij Këshilli është shumë i nevojshëm e sidomos tash në kohën kur ka marrë hov të madh zhvillimi i teknologjisë. Në aspektin akademik është shumë e nevojshme të bëhet promovimi i vlerave hulumtuese duke iu shmangur plagjiaturës sepse edhe aplikimi i teknologjisë e sidomos inteligjencës artificiale mund të krijoj rezultate negative në plagjiaturë. Andaj qëllimi i këtij Këshilli përveç aspektit disiplinor mendoj se duhet orientohet më shumë në dimensionin e sensibilizimit dhe preventives rreth proceseve plagjiaturës ku përmes fushatave dhe dokumenteve promovuese mund të arrihet ky qëllim.

Nga aspekti i sigurimit të cilësisë foli edhe z. Emin Uka, Udhëheqës i Divizionit për Sigurimin e Cilësisë i cili shtoi se ky Këshill ka vlerë të madhe për institucionin tonë e sidomos nga aspekti i cilësisë sepse mendoj që ky Këshill i Etikës mund të krijojë dhe instalojë kulturë etike si vlera të cilat do ti jetësojmë. Sipas standardeve akredituese roli dhe puna e këtij Këshilli është shumë dimensional dhe ndihmon institucionin në përmbushjen e tyre.

Në këtë takim u prezantua përbërja e Këshillit dhe u diskutua për hartimin e draftit për plani vjetor të punës së Këshillit të Etikës i cili do të jetë një udhërrëfyes për punën dhe dëshmi e angazhimit për të përmbushur përgjegjësitë ndaj vlerave të përbashkëta dhe i cili do të përfshijë aktivitete të ndërgjegjësimit mbi integritetin akademik, organizimin e trajnimeve dhe ligjëratave për student dhe stafin akademik.

Takimi u finalizua me zotimin e anëtarëve për bashkëpunim të ngushtë dhe përkushtim në përmbushjen e mandatit të Këshillit.



IV. REZULTATET / VENDIMET KRYESORE

- Konstituimi i Këshillit të Etikës
- Fillimi i hartimit të Planit Vjetor të aktiviteteve të Këshillit të Etikës